



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

**RREGULLORE
PËR MIRATIMIN OSE REFUZIMIN E NDRYSHIMEVE THELBËSORE TË
STATUTIT TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT**

Miratuar me vendim Bordi nr. 138, datë 21.12.2015

**Neni 1
Objekti**

Objekti i kësaj rregullore është përcaktimi i rregullave për miratimin ose refuzimin e ndryshimeve thelbësore të statutit të shoqërisë së sigurimit.

**Neni 2
Baza Ligjore**

Kjo rregullore hartohet në bazë të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të ndryshuar dhe nenit 57, pika 3 të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

**Neni 3
Procedura dhe afatet e miratimit të ndryshimeve thelbësore të statutit**

1. Ndryshimet thelbësore të statutit bëhen me miratimin paraprak të Autoritetit brenda 10 ditëve nga depozitimi i propozimit për ndryshim.
2. Ndryshimet thelbësore të statutit përveç miratimit paraprak, miratohen përfundimisht nga Bordi i Autoritetit në mbledhjen më të afërt të radhës nga data e miratimit paraprak.

**Neni 4
Ndryshimet thelbësore**

1. Do të konsiderohen si ndryshime thelbësore të statutit ndryshimet e mëposhtme:
 - a) Rritja dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar të shoqërisë së sigurimit;
 - b) Zgjerimi ose ndryshimi i objektit të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit;
 - c) Çdo ndryshim i strukturës aksionare të shoqërisë së sigurimit;
 - d) Ndryshime që prekin kompetenca të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë;
 - e) Ndryshime që prekin kompetencat dhe përbërjen e organeve të ngarkuara me administrimin e shoqërisë.
2. Do të konsiderohet si ndryshim thelbësor i statutit çdo ndryshim tjetër që direkt ose indirekt prek një nga pikat e mësipërme dhe konsiderohet si thelbësor nga Autoriteti.

Neni 5

Miratimi paraprak i ndryshimeve thelbësore të statutit

1. Shoqëria e sigurimit, përpara mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, depoziton në Autoritet një kërkesë të argumentuar për ndryshimet thelbësore të statutit. Kërkesa duhet të specifikojë arsyen e ndryshimeve thelbësore të statutit si dhe të përmbajë propozimin konkret të dispozitës/dispozitave që kërkohen të ndryshohen.
2. Autoriteti, kur konstaton se propozimi nuk është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 52/2014 “Për sigurimin dhe risigurimin” si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, mund t’i kërkojë shoqërisë plotësimin ose korrigjimin e propozimit brenda një afati të përcaktuar në njoftimin përkatës.
3. Brenda 10 ditëve nga depozitimi i kërkesës për ndryshimet thelbësore të statutit, Autoriteti nëpërmjet Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, nëse vëren se propozimi për ndryshimet thelbësore është në përputhje me kërkesat ligjore, njofton shoqërinë për miratimin paraprak.

Neni 6

Dokumentacioni për ndryshimet thelbësore të statutit

1. Pas marrjes së miratimit paraprak, shoqëria e sigurimit depoziton në Autoritet vendimin e Asamblesë së Përgjithshme për ndryshimin e statutit si dhe dokumentacionin më poshtë:
 - a) Në rastin e rritjes së kapitalit themeltar shoqëria depoziton të dhëna në lidhje me burimin e kapitalit si dhe dokumentacionin sipas nenit 16 të ligjit nr. 52/2014, për zvogëlimin e kapitalit depozitohet relacionin justifikues, raportin e audituesit të autorizuar.
 - b) Në rastin e zgjerimit ose ndryshimit të objektit të veprimtarisë relacionin justifikues.

- c) Në rastin e ndryshimit të strukturës aksionare përveç dokumentacionit të parashikuar nga nenet 16 dhe 17 të ligjit nr. 52/2014 edhe kontratën e shitblerjes të aksioneve dhe të dhëna në lidhje me aksionarin e ri.
 - d) Në rastin e ndryshimit të kompetencave të organeve të ngarkuara me administrimin e shoqërisë, relacioni justifikues.
2. Autoriteti, nëse e çmon të nevojshme, mund të kërkojë rast pas rasti edhe dokumente apo informacione shtesë, përveç sa është parashikuar në këtë nen.

Neni 7

Miratimi përfundimtar i ndryshimeve thelbësore të statutit

1. Pas miratimit paraprak ndryshimet thelbësore të statutit miratohen nga Bordi i Autoritetit.
2. Me plotësimin e dokumentacionit sipas nenit 6 të kësaj rregulloreje Bordi i Autoritetit vendos për miratimin e propozimit për ndryshimet thelbësore të statutit të shoqërisë.
3. Shoqëria e sigurimit depoziton në Autoritetin statutin e ndryshuar brenda 10 ditëve kalendarike nga regjistrimi në QKR të ndryshimeve të statutit.

Neni 8

Refuzimi i ndryshimeve thelbësore të statutit

1. Bordi i Autoritetit refuzon ndryshimet thelbësore të statutit, kur propozimi i shoqërisë së sigurimit:
 - a) nuk plotëson kërkesat e nenit 6 të kësaj rregulloreje, dhe/ose
 - b) është në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 52/2014 “Për sigurimin dhe risigurimin” si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
2. Ndryshimet e statutit të cilat janë refuzuar nga Bordi i Autoritetit nuk regjistrohen në QKR.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.